




PARTIA DEMOKRATIKE
E KOSOVËS

Prishtinë, 18.10.2017

Partia Demokratike e Kosovës

Për: Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia



Duke pasë për bazë Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ato Lokale në Kosovë, respektivisht nenin 118 pika 4 të Ligjit 03/L-256 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-073 Partia Demokratike kërkon rishqyrtimin e vendimit të vet ZL Anr. 220/2017.

Partia Demokratike paraqet kundërshtime në Vendimin e PZAP-së ZL Anr. 220/2017 dhe nuk pajtohet me vendimin e PZAP-së për shqiptimin e gjobës dhe konsideron se paneli zgjedhor nuk ka vepruar drejt në përputhje me Nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore 13/2013

Fëmijët që shihen në video janë fëmijë të kandidatit për Kryetar Komune dhe se në asnjë rregull zgjedhore nuk ndalohen që fëmijët e kandidatëve të mos jenë me prindërit e tyre. Rregulla 5.2 nënkupton mos përdorimin e fëmive në mënyrë të organizuar qoftë ata të shkollave fillore apo të mesme që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeçare, prandaj Paneli Zgjedhor duhet të kuptojë qartë rregullën në fjalë dhe se nuk mund të zbatohet ajo në mënyrë të përgjithësuar. Kjo rregull duhet të kuptohet jo me pjesëmarrje pasive të këtyre kategorive, por me atë aktive që është dallim që duhet të kihet parasysh nga PZAP.

PZAP duhet të shqyrtojë vendimin e vet dhe ta hudhë poshtë dhe të sjellë vendim të drejtë.

për Përfaqësuesi i autorizuar,

Gani Koci

